



## **KUVENDI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 11, 12.2 shkronja d) dhe 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 21 paragrafi 1.1, në pajtim me nenet 5 dhe 6 paragrafi 1.2 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, në pajtim me dispozitat e neneve 24 dhe 25 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenet 14, 15 paragrafi 2.4 dhe nenit 17.1 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë nr.prot.05-2084 të datës 25.03.2024 për themelimin e Poliklinikës Specialistike në Komunën e Podujevës, Vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë nr.prot.05-1806 të datës 13.03.2024 për Miratimin e Planit të Veprimit për funksionalizimin e Poliklinikës në Podujevë, si dhe në Kërkesë të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës me nr.1043 të datës 12.04.2024, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 18 prill 2024, miratoi këtë,

### **V E N D I M**

#### **PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME NË SHFRYTËZIM AFATGJATË SHËRBIMIT SPITALOR KLINIK UNIVERSITAR TË KOSOVËS - SHSKUK**

##### **Neni 1**

Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës SHSKUK, i jepet në shfrytëzim afatgjatë prona e paluajtshme e Komunës, e evidentuar në Certifikatën Pronësore nr.08-942/06-0023271/24 të datës 11.04.2024, njësia kadastrale parcelë P-71712062-01012-10, në sipërfaqe 3035 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Podujevë, ku është i përfshirë edhe objekti ekzistues shëndetësor.

##### **Neni 2**

Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në nenin 1, ka për qëllim funksionalizimin e Poliklinikës Specialistike në Komunën e Podujevës, themeluar nga Ministria e Shëndetësisë me Vendimin nr.prot.05-2084 të datës 25.03.2024.

##### **Neni 3**

Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në nenin 1 sipas këtij vendimi është afatgjatë në periudhë 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite.

##### **Neni 4**

Shfrytëzimi i pronës sipas këtij vendimi jepet pa kompensim.

#### Neni 5

Kontrata për dhënie në shfrytëzim e pronës sipas këtij vendimi nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe përfaqësuesi i SHSKUK-së.

#### Neni 6

Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të Komunës për raste të veçanta evidentohet në Regjistrin e të drejtave pronësore në Elaboratin Kadastral.

#### Neni 7

Zbatimin e këtij vendimi, nën përkujdesjen e Kryetarit të Komunës, e bëjnë Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

#### Neni 8

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

#### **Me këtë vendim njoftohen:**

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministria e Shëndetësisë

SHSKUK

Drejtoritë e Komunës

Nr.Prot. 01-463/06-0025470/24  
Podujevë, datë: 18.04.2024



Përfaqësuesi i Kuvendit  
Hilmi Hoxha



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životte Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71712062-01012-10

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

08-942/06-0023771/24

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

11.04.2024 - 11:49

Komuna / Opština / Municipality:

PODULJEVË / PODULJEVO / PODULJEVË

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Poduljevë / Podujevo / Podjevë

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

PODULJEVË / PODULJEVO / PODULJEVË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Pëshkrim Opis Description	Krijuar më daten Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-71712062-01012-10	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		3035	251-2003		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
QYTET-R. HAKIF ZEJNULLAHU				



**A.2 LLOJTI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE**

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcesës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcesës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m <sup>2</sup> ) Površina (m <sup>2</sup> ) Area (m <sup>2</sup> )
1	Tokë Tjetër/Ostalo Zemljište/Other Land	Jo Pjellorë/Neplošno/Uproductive		2538
2	Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land	Shtëpi-Ndërtesë/Kuca-Zgrada/House-Building		497

**B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR**

Te drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Liceni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Poseidin individual / Individualna Drzavina / Single Possessor	<b>Komuna e Podujevës</b>	600534946	PODUEVË / PODUEVO / PODJEVË /		NUHI GASHI	1/1	294/2019	01.08.2019



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

**KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN**

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : **PODUJEVË**

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: **Podujevë**

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-71712062-01012-10	Parcelë / Parcela / Parcel	3035



Shkalla/Razmera/Scale: 1:574

Punoi/Obradio/Created: Valon Beselica

Nënshkrimi/Potpis/Signature: 

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 11.04.2024

Koha/ Vreme/ Time: 03:35:13